



Vepra: “2 Hana”

Autore: Erëmira Çitaku

Viti: 2009

Zhanri: video-performancë me flautë


Vepra “2 Hana” e Erëmira Çitakut është një video-performancë 17 minutëshe, e cila i bashkangjitet librit “Shoshë” në formë të videos. Performanca përbëhet prej një videoje, koncepti i së cilës është krijuar nga artistja Çitaku. Dy muzicentët (njëri prej tyre vetë autorja e veprës), paraqiten me instrumentet e tyre në një dhomë të errësuar para projekcionit të videos. Kjo performancë karakterizohet me mënyrën e komunikimit të autores (me instrumente muzikore dhe poezi) me një vepër të video artit. Koncepti i videos përmban një montazh filmik, që veç tjerash paraqet dy hëna në qiell njëkohësisht: Motivi i hënës, që njihet si simbol i cikleve të jetës, e që njihërit paraqesin përjetësinë, artistja Erëmira Çitaku e sheh si një lojë mes planetesh (bazuar në largësitë e ndryshueshme në mes të tokës dhe marsit), por nga ana tjetër këto hëna paraqesin edhe një ëndërr të autores prej të cilës ajo u inspirua për këtë realizim. Motivi i hënës lidhet gjithashtu me ciklin e femrës, përkatësisht me plleshmërinë apo krijimin e jetës në tokë. Gjithashtu, hëna është përgjegjëse për baticat dhe zbaticat në tokë. Montazhi i kësaj videoje përcillet me melodi dhe poezi që lidhen me përmbajtjen e veprës. Poezia thuhet në disa gjuhë të botës: shqip, anglisht, italisht, bullgarisht, flamisht dhe frëngjisht. Gjithashtu, dy instrumentistët që ndodhen para

projekcionit interagojnë aty për aty përmes melodive, tingujve apo zhurmave me videon e projektuar. Kjo vepër artistike është një kombinim i zhanreve të ndryshme të artit me anë të të cilave autorja e plason veten si një pioniere e këtij lloji të artit në Kosovë.

© Dr. Penesta Dika 2010

Kjo video-performancë u prezentua në këto vende:

- ❖ *8.03.2010 Belgium – Louven- Lemmens Institute*
- ❖ *1.03.2011 Kosova- Center for Contemporary Art- Stacion*
- ❖ *23.09.2011 Germany Leipzig- Theatre - “Lofft” Leipzig ❖*
24.09.2011 Germany Dresden- Societaets Theater
- ❖ *04.12.2012 France – Paris- Theatre “Le Palace” Paris*



Erëmira Çitaku / koncepti, muzika, teksti, kamera

Liburn Jupolli/ piano, Besa berberi /soprano, Luan Durmishi/tenor, Visar Kuqi/violinë

Avni Krasniqi/ audio produksioni

Yll Çitaku/ montaxha filmike

Nurhan Qehaja/ vallëzim

Zhanri: Video-performancë me instrumente muzikore, këndim dhe performim me shoshë

Vepra “Shoshë” e artistes dhe flautistes Erëmira Çitaku është një video-performacë me instrumente muzikore, në të cilën artistja si dhe muzikantët e tjerë luajnë aty për aty para publikut me flautë, këndim (Besa Berberi dhe Luan Durmishi), violinë (Visar Kuqi), dhe piano me kanaqe të pijes coca-cola duke u pozicionuar para projektimit të një videoje. Artistja Çitaku përveç me flautë, performon edhe me një shoshë të mbushur me fara të fasules. Muzika, krijuese e të cilës është vet artistja Çitaku, paraqitet për shikuesin si pjesë integruese e veprës. Motivi kryesor i videos “Shoshë” është një valltare, e cila performon me një shoshë në dorë duke bërë lëvizje të

buta dhe harmonike para një pamje idilike të një deti të qetë. Këtë përshtypje e ndihmon edhe fakti që e tërë skena zhvillohet gjatë perëndimit të diellit. I tërë arranzhimi paraqitet i pasqyruar ndaj aksit horizontal, mirëpo është i transformuar sa i përket kohës së performimit të valltares. Artistja me këtë pasqyrim reflekton mbi faktin që njeriu me kalimin e kohës mund të ketë pamje, apo perspektiva të ndryshme mbi po të njëjtën ngjarje; njeriu mund të ketë vija të ndryshme të horizontit si pikënisje për analizë të një çështjes. Apo, njeriut i duhet të reflektojë mbi veten, mbi vendimet e tij për të kuptuar një çështje më thellë, për ta zënë kuptimin më në thelb. Njeriu duhet të shohisë të dhënat dhe faktet për të marrë përfundime adekvate. Valltarja vazhdon performimin me shoshë duke u paraqitur pranë hijes së saj, apo ballë për ballë hijes së saj. Gjithashtu, ajo paraqitet së bashku me shohë duke hyrë në hijen e saj. Përballjet e njeriut me veten, zbulimi i vetes duke hyrë në të, përkatësisht duke kaluar nëpër hijen e tij janë tema që na paraqiten si përmbajtje nga ky këndvështrim. Videoja përfundon me skenën ku valltarja me shoshë paraqitet para dy perëndimeve të diellit. Ajo vazhdon të performojë në mes tyre dhe së fundi kthehet nga shikuesi për të dalur nga skena duke e hedhur shoshën pas saj. Valltarja tani paraqitet si një person i kënaqur me arritjet e tij, me shoshitjet e gjërave rreth tij, me njohjen dhe hulumtimin e ambientit të tij. Asaj tanimë nuk i duhet shosha për të shoshitur. Si përfundim paraqitet rëra e plazhit dhe mbi të fjala e shkruar “Shoshë”, te cilat e lënë shikuesin të asocohet në shtjellimin, përpunimin apo filtrimin e informatave të shumta, me të cilat u ballafaqua valltarja gjatë gjithë vallëzimit të saj me shoshë.

© Dr. Penesta Dika 2010

Kjo video-performancë u prezentua në këto vende:

- ❖ *8.03.2010 Belgium – Louven- Lemmens Institute*
- ❖ *1.03.2011 Kosova- Center for Contemporary Art- Stacion*
- ❖ *23.09.2011 Germany Leipzig- Theatre - “Lofft” Leipzig* ❖
24.09.2011 Germany Dresden- Societaets Theater
- ❖ *04.12.2012 France – Paris- Theatre “Le Palace” Paris*



Vepra: “Sh...sh...sh...sh”

Autore: Erëmira Çitaku

Viti: 2010

Zhanri: Video Performance

Artistja Erëmira Çitaku na sjell gjithmonë befasira të këndshme. Kësaj radhë na sjell një ninullë me të cilën synon të dekonstruktojë një traditë pabarazie dhe të pushteteve të ndara në mënyrë të prerë gjatë historiesë sonë. Shpesh kemi ndier ninulla të kënduara për djemtë që të bëhen trima e luftëtarë por shumë rrallë për vajzat që të bëhen të zonjat e mbretëresha. Nuk është që patëm pak prej tyre por i kujtuam pak dhe ende pak i kujtojmë.

Po t’u kishim kënduar më shumë shoqeve, vajzave, motrave dhe dashnoreve tona do të kishim gjasa për më shumë histori për **Ato** sesa për **Ata (HI-Story)**.

MSc Ariana Qosaj-Mustafa

Kjo video-performancë u prezentua në këto vende:

- ❖ 8.03.2010 Belgium – Louven- Lemmens Institute
- ❖ 1.03.2011 Kosova- Center for Contemporary Art- Stacion
- ❖ 23.09.2011 Germany Leipzig- Theatre - “Lofft” Leipzig ❖
24.09.2011 Germany Dresden- Societaets Theater
- ❖ 04.12.2012 France – Paris- Theatre “Le Palace” Paris



Art work: “Iracionalizma”

Author : Erëmira Çitaku

Year: 2010

Genre: Video Performance

Iracionalizma is a poetry from the mind for the mind, which becomes alive and touchable only when it is emotionally wrapped by the music, two voices that interpret it, and the film. This converts it into an art work.

This art work’s dynamics develops itself in the zone where the rational meets the irrational, the free will meets the imposed one, and the approach meets the flight. This zone seems to be like a neutral zone between two state borders – Madness, Abnormality, Exploration, on one side, and

Control, Daily Life, and the Ordinary, on the other side. Here, we begin losing control over our mind and our behavior. This zone is full of streams, fear, doubt and anxiety. We have all been there, and we still pass by this zone in our lives. But, we insist on avoiding, not only this zone, but even the conversations about it, because that is the only way for the others to love us, and as a result, for us to love ourselves. Developed between two almost magnetic fields, in this art work's zone, one is drawn by the family warmth, the everyday life, and common things, on one side, and on the other side, by exploration, achievement, and coldness of an individualistic competitive city like Paris.


This art work makes you question your definition of normal and abnormal. It makes you smile and feel the sweetness of the child, whom you would call insane if he was a bit older; it makes you think about the fear that is provoked by the categories normal and abnormal, no matter in which side you feel you are.

A *fearful fear*, as Çitaku names it in her poetry, is the fear of the normal afraid of being close to the abnormal, there where the in-between zone is – the neutral zone. In this context, the human mind is simultaneously a blessing and a curse for the human being. The main value of this art work is thus psychological. It provokes us and calls us for a conversation about the fear from madness, fear from our pure impulses, and fear from death caused by the fear from life. *Iracionalizma* talks about the detachment from our pure and often creative impulses, about the fear in our minds which we – the society – create by enforcing values and anti-values, and by imposing written and mostly unwritten rules; *Iracionalizma* calls us to talk about them.

Emine Vala

Kjo video-performancë u prezentua në këto vende:

- ❖ ***8.03.2010 Belgium – Louven- Lemmens Institute***
- ❖ ***1.03.2011 Kosovë- Center for Contemporary Art- Stacion***
- ❖ ***23.09.2011 Germany Leipzig- Theatre - “Lofft” Leipzig ❖***
24.09.2011 Germany Dresden- Societaets Theater
- ❖ ***04.12.2012 France – Paris- Theatre “Le Palace” Paris***



Vepra: “E train”

Autore: Erëmira Çitaku

Viti: 2010

Zhanri: Music live performance me video-animacion

Erëmira Çitaku / luajtje me flautë gjatë performancës live

Avni Krasniqi / muzika dhe audio produksioni

Skender Krasniqi / animacion

Meriton Ferizi / fagot dhe harmonikë ne DVD

Bujar Berisha / interpretim i poezisë në librin Shoshë

Zein El-Abdin Fouad / interpretim i poezisë live

Vepra “E train” e artistes dhe flautistes Erëmira Çitaku është një video-performacë me flautë dhe harmonikë. Koncepti i kësaj vepre është i tillë që derisa projektohet një animacion i realizuar nga Skender Krasniqi, i cili është krijuar në bazë të poezisë së artistes Çitaku, luhet aty për aty para publikut me dy instrumente muzikore (flautë dhe harmonikë) para projektimit të këtij animacioni. Gjithashtu, gjatë performancës Zein El-Abdin Fouad bën interpretim të poezisë së autores. Një varinatë tjetër e kësaj vepre, e cila i bashkangjitet lexuesit të librit “Shoshë” në formë të DVD-së është e përpiluar me përcjellje të muzikës, për të cilën është përgjegjës Avni Krasniqi, ndërsa luan me instrumente Meriton Ferizi (fagot dhe harmonikë). Interpretimin e poezisë e realizon Bujar Berisha.

Duke dashur ta zbërthejmë përmbajtjen e kësaj vepre duhet t’i qasemi si nga aspekti vizuel ashtu edhe nga ai muzikorë dhe nga ai i poetikës. Animacioni në fjalë, i cili është i realizuar bardhë e zi dhe kryesisht dy-dimenzional na paraqet fillimisht një formë të rëndë dhe të madhe mbi të cilën arrin të ngjitet si dhe arrin ta tejkalojë një gjallesë katërkëmbëshe. Kjo mund të vihet në analogji me tekstin e poezisë i cili thotë: “Don’t kill what is born to live” (Mos vraj atë që ka lindur për të jetuar).

Gjallesa e paraqitur na e vizualizon luftën e saj për ekzistencë, si dhe mbijetesën e saj. Pastaj na paraqitet një tren me udhëtarë dhe gjallesa pas tij, pothuajse duke e ndjekur. Në kontekst me vjerrshën gjallesa po e ndjek trenin e jetës së saj. Gjallesa katërkëmbëshe paraqitet sfiduese duke dashur që ta mbërrijë trenin e jetës së saj. Ajo për shembull me brinjtë e saj e rrëzon një pemë, e cili në këtë rast simbolizon një barrierë. Pastaj, gjatë gjithë animacionit gjallesa në fjalë paraqitet duke kaluar nëpër sfida të ndryshme, njëherë duke u ngutur nga njëra anë dhe njëherë nga tjetra, njëherë e paraqitur si gjallesë e bardhë, njëherë si gjallesë e zezë.

Animacioni përfundon duke e tretur, përkatësisht duke e shpërbërë gjallesën në drejtim të shikuesit. Me këtë shikuesi ndihet i involvuar personalisht në jetën dhe sfidat e jetës së kësaj gjallese. Problemet e saj bëhen automatikisht reflektim mbi problemet e shikuesit, përkatësisht qëndrojnë si pasqyrë mbi problemet që na sjell jeta.

© Dr. Penesta Dika 2010

Kjo video-performancë u prezentua në këto vende:

- ❖ *8.03.2010 Belgjikë – Louven- Lemmens Institute*
- ❖ *1.03.2011 Kosovë - Center for Contemporary Art- Stacion*
- ❖ *23.09.2011 Germany Leipzig- Theatre - “Lofft” Leipzig ❖*
24.09.2011 Germany Dresden- Societaets Theater
- ❖ *04.12.2012 France – Paris- Theatre “Le Palace” Paris*



Vepra: “Banka Suficit”

Autor: Erëmira Çitaku

Viti: 2012

Zhanri: Instalacion në Hapsirë

Kjo vepër u instalua në Pallatin e Rinisë në Prishtinë - Kosovë në projektin “Prishtinë Mon Amour”



Vepra: “Is this originale”

Autor: Erëmira Çitaku

Viti: 2011

Zhanri: Video Performancë

U prezentua në DAM Festivalin Ndërkombëtar (www.damfest.com)

DAM Festival (Festivali Internacional i Muzikantëve të rinj) është i pari i këtij lloji që është organizuar në Republikën e Kosovës. Tani është bërë traditë dhe qëllimi i tij është të mbështesë muzikantët e rinj dhe artistët e muzikës kontemporane.



Vepra : “Babyalarm”

Autor: Erëmira Çitaku

Viti: 2015

Zhanri: Performancë muzikore - Flaut, zë, efekte elektronike

Kjo vepër u prezentua në:

- **Projektin Baushtelle (www.baushtelle.org) në Prishtinë – Beograd, Zurich, është eksperiment me efektet elektronike.**
- **Festivalin Ndërkombëtar Femart festival regional nga artiste femra per te drejtat e njeriut - "FemArt" nga 7-11 Tetor 2015, në Prishtinë. Sjellë art origjinal të krijuar dhe të dizajnuar nga femrat duke përfshirë: Shfaqje teatri, filma dokumentarë dhe filma të shkurtë, lexime, punëtori, ekspozita, performanca, promovime librash, diskutime, prezentime si dhe forma të tjera Arti nga femra të Kosovës dhe regjionit si (Maqedonia, Serbia, Shqipëria dhe të tjerë) (www.femar-ks.com)**



Vepra: “The House of being”

Autor: Erëmira Çitaku

Viti: 2015

Zhanri: Performancë muzikore - Flaut, zë, efekte elektronike

Kjo vepër u prezentua në projektin Baushtelle (www.baushtelle.org) në Prishtinë – Beograd, Zurich, është eksperiment me efektet elektronike.

Baushtellë: Balkan Temple është një projekt artistik i cili bashkon njerëzit me pyetjen “Në çka beson” në Prishtinë, Beograd dhe Zurich.

